

KUSHTET DHE RREGULLAT E OFERTËS CASHBACK TË MTPL

Këto Kushte dhe Rregulla rregullojnë Ofertën e Kthimit Mbrapsht të Parave për Policë Sigurimi TPL të ofruar përmes aplikacionit Mylute. Duke marrë pjesë në këtë ofertë, ju pranoni rregullat e përshkruara më poshtë.

1. Përshtatshmëria

- 1.1. Kjo ofertë zbatohet vetëm nëse automjeti është regjistruar në emrin tuaj.
- 1.2. Ju duhet të jeni përdorues i verifikuar në Mylute me një llogari Pagese aktive me lutePay.
- 1.3. Oferta zbatohet vetëm për automjetet që plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë për të marrë një Policë Sigurimi TPL në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.
- 1.4. Oferta është e vlefshme vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës të komunikuar nga lute.

2. Kthim mbrapsht i parave për Kontrollin e Çmimit të Policës TPL

- 2.1. Përdoruesit mund të kontrollojnë deri në dy (2) automjete unike të regjistruara në emrin e tyre.
- 2.2. Për çdo kontroll të vlefshëm të çmimit, Klienti merr 1,000 LEK mbrapsht në llogarinë e tij.
- 2.3. Kthimi mbrapsht i parave në llogari për kontrollin e çmimit zbatohet pavarësisht nëse blihet apo jo një policë sigurimi TPL.
- 2.4. Oferta e kthimit mbrapsht të parave në llogari është e vlefshme për një (1) javë nga data e kryerjes së kontrollit të parë të vlefshëm të çmimit.

3. Kthim mbrapsht i parave në llogari për Aktivizimin e Suksesshëm të Policës së Sigurimit TPL

- 3.1. Klientët që përfundojnë me sukses blerjen e një police Sigurimi TPL dhe plotësojnë të gjithë kriteret e pranueshmërisë nga siguruesi, marrin 2,000 LEK mbrapsht në llogari në vend të 1,000 LEK.
- 3.2. Marrja e 2,000 LEK mbrapsht në llogari jepet vetëm pasi polica e sigurimit TPL të jetë aktivizuar dhe konfirmuar.
- 3.3. Nëse një klient kontrollon dy automjete dhe aktivizon një ose të dyja policat e Sigurimit TPL:
 - Klienti merr 1,000 LEK mbrapsht në llogari për çdo kontroll të vlefshëm të çmimit të automjetit (deri në dy kontrolle gjithsej), pavarësisht nëse policat e Sigurimit TPL janë aktivizuar.

- Klienti gjithashtu merr 2,000 LEK mbrapsht në llogari për çdo policë sigurimi TPL të aktivizuar me sukses (deri në dy polica sigurimi TPL, nëse të dy automjetet e kontrolluara rezultojnë në aktivizim Police Sigurimi TPL).

Kthimi mbrapsht i parave në llogari për kontroll çmimi dhe kthimi mbrapsht i parave në llogari për aktivizim police Sigurimi TPL janë oferta të veçanta por edhe mund të kombinohen.

4. Kthimi mbrapsht i parave në llogari:

4.1. Të gjithë shumat e kthimit mbrapsht të parave në llogari të përfutuara, kreditohen direkt në llogarinë e Pagesës që klienti ka me lutePay.

4.2. Paratë kreditohen në llogarinë e Pagesës së Klientit brenda pesë (5) ditësh pune nga momenti kur veprimi bëhet i vlefshëm:

- Kontrolli i çmimit është kryer, dhe/ose
- Aktivizimi i policës së Sigurimit TPL është konfirmuar.

5. Kufizimet dhe Përjashtimet

5.1. Kthimi mbrapsht i parave zbatohet vetëm për shërbimet e Policave TPL të aksesueshme përmes aplikacionit Mylute.

5.2. Automjetet që nuk janë të regjistruara në emrin e klientit nuk janë të vlefshme për ofertën.

5.3. Kontrole të të njëjtit automjet nuk japin përfitim shtesë.

5.4. Klientët që shkelin kushtet e përdorimit të Mylute ose të lutePay, përpiqen për të kryer mashtrime ose keqpërdorin ofertën, mund të përjashtohen.

6. Ndryshimet dhe Përfundimi i Ofertës

6.1. lute rezervon të drejtën të modifikojë, zgjasë ose terminojë ofertën e kthimit të parave mbrapsht në llogari në çdo kohë pa njoftim paraprak.

6.2. Çdo ndryshim në këto Kushte dhe Rregulla do të publikohet në faqen zyrtare të lute.

7. Kontakt

Për pyetje ose suport në lidhje me këtë ofertë, ju lutemi kontaktoni shërbimin e klientit Mylute përmes kanaleve zyrtare të Shërbimit të Klientit, në info@lute.al, +355 44505060, ose direkt përmes aplikacionit Mylute.